

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MotorSport Albania” shpk

Sot, në datë 11.01.2023, unë themeluesi, Edvin Kasimati, atësia Zyhdi, shtetas Shqiptar, me numër personal identifikimi H20109086A, i datëlindjes 09.01.1972, lindur dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1
Themelimi

- 1) Emri i shoqërisë është “MotorSport Albania” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2
Objekti

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e:
 - a) Organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve sportive, motoçiklistike dhe çiklistike; duke përfshirë po jo vetëm, gara sportive në territorin e Shqipërisë, evente trajnimi dhe me karakter turistik, në Shqipëri dhe territorin e Ballkanit.
 - b) Ofrimin e shërbimeve të ndryshme mbështetëse për këto evente; duke përfshirë asistencat në trajektore, kohëmatjet e nevojshme, sistemet satelitare të monitorimit për sportistët, ndërmjetësimin për ofrimin e shërbimit të akomodimit të pjesëmarrësve brenda dhe jashtë vendit dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme.
 - c) Importimin dhe blerjen e mjeteve të transportit, pjesëve të këmbimit, pajisjeve të tjera ndihmëse dhe që lidhen me aktivitetin kryesor të shoqërisë.
- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

Neni 3
Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Njësia bashkiake nr. 11, Rruga Gjergj Balshaj, Ndërtesa Nr. 6, Kati 2, Zyra 22, pranë Ura Kamëz, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 120,000 (Një qind njëzet mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortakut Edvin Kasimati.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Administratori

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Edvin Kasimati, atësia Zyhdi, shtetas Shqiptar, me numër personal identifikimi H20109086A, i datëlindjes 09.01.1972, lindur dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", *Kodit Civil* dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAK I VETËM
I SHOQËRISE ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MotorSport Albania” shpk


EDVIN KASIMATI

Edvin Kasimati
Ortak i vetëm